

# FJALORËT SHKOLLORË NË 100-VJETORIN E KONGRESIT TË MANASTIRIT (SCHOOL DICTIONARIES IN THE 100-TH ANNIVERSARY OF THE CONGRESS OF MANASTIR)

Natasha SOTIRI

Instituti i Gjuhësisë dhe i Studimeve Letrare,  
Qendra e Studimeve Albanologjike, Tiranë

SHQIPËRI

E-mail: [natashasotiraj@hotmail.com](mailto:natashasotiraj@hotmail.com)

## PËRMBLEDHJE

Ende sot, në 100-vjetorin e Kongresit të Manastirit, nuk ka fjalorë shpjegues të shqipes për moshën shkollorë. Kjo nuk do të thotë që nuk është punuar fare në këtë fushë. Historia e përpjekjeve të leksikografisë shqiptare dëshmon për punë të pareshtur, por ende të pakurorëzuar. Pikërisht për këtë arsye dr. Natasha Sotiri dhe prof. dr. Hajri Shehu, leksikologë e leksikografë në Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë, ndërmoren hartimin e një fjalori të tillë. Puna tashmë ka përfunduar dhe *Fjalori* shpresohet të botohet brenda këtij viti jubilar. Duke lënë mënjane shtjellimin e vlerave të tij shkencore e praktike, e pamundur të bëhet kjo në një përmbledhje prej pak radhësh, cekim vetëm dy-tri veçanti:

- Hartimit të fjalësit dhe përzgjedhjes së shembujve për shembullzimin e fjalëve i ka paraprirë një punë studimore rreth gjuhës së letërsisë artistike për fëmijë në gjuhën shqipe.

- Fjalët janë shpjeguar në pajtim me aftësitë mendore, nivelin gjuhësor dhe shkallën e formimit kulturor të moshës shkollorë, ndërsa shembujt janë vjelë nga librat më të njohur për fëmijë.

- Për t'ia përshtatur më mirë kuptimit që shpjegojnë, shembujt shpesh janë redaktuar, por pa cenuar lidhjen e tyre me kontekstin e pjesëve letrare nga janë nxjerrë: kjo për të mprehur kuj-

tesën e fëmijëve dhe t'ua bëjë më të lehtë e më të këndshëm përdorimin e *Fjalorit*.

**Fjalët kyçe:** *Leksikografi shqiptare, fjalorë shkollorë, kriteret e hartimit, letërsi për fëmijë.*

**Key words:** *Albanian lexicography, scholarly dictionaries, compilation criteria, literature for children.*

## HYRJE

Në 100-vjetorin e Kongresit të Manastirit kemi të drejtë të pyesim: "Ku jemi ne me fjalorët shkollorë një shekull pas vendosjes së alfabetit të përbashkët shqip? Cila është zanafilla dhe rrugëtimi i tyre deri në ditët e sotme? Ç'rol kanë luajtur ose duhet të luajnë ata në diturimin e brezit të ri?

Arsimi dhe kultura shqiptare nuk do të mund të lulëzonin pa një alfabet të përshtatshëm, të saktë e të përbashkët për të gjithë shqiptarët. Për këtë arsye, Kongresi i Manastirit, që hyri në histori si "Kongresi i Abëcësë", përbën themelin nga ku nisën përpjekjet e sukseshme për zhvillimin e gjithanshëm të diturisë shqiptare në përgjithësi dhe të leksikologjisë e të leksikografisë në veçanti.

Kanë qenë të parreshtura dhe të vyera përpjekjet e studiuesve dhe të patriotëve shqiptarë për grumbullimin dhe studimin e leksikut të përgjithshëm e terminologjik të gjuhës shqipe, për hartimin e fjalorëve fillimisht dygjuhësh e më vonë edhe njëgjuhësh. Më të vonshme kanë qenë

përpjekjet për studimin e leksikut për fëmijë dhe për hartimin e fjalorëve për ta. Kjo është krejt e natyrshme, sepse leksikografia shkollore është një gjini leksikografike më vete dhe një dukuri e re edhe për botën shqiptare. Për gjuhën frënge p.sh. ky tip fjalori nis me *Larousse des debutants*, botimi i parë i të cilit e pa dritën më 1949 dhe mbeti i vetëm deri më 1970, kur Ministria e Arsimit të Francës udhëzoi zyrtarisht përdorimin e Fjalorëve shkollorë gjatë mësimin në klasa [1]. Kurse në Shqipëri, përpjekjen e parë për të hyrë në këtë udhë të re leksikografike e shënon botimi, më 1934, i fjalorit me titull: *Fjalorth i librit të leximit për moshën e njomë*, me autor Mati Logorecin, me 1900 fjalë të vjela e të grumbulluara nga librat e leximit për fëmijë, si dhe drejtpërdrejt nga goja e popullit. Pra, për herë të parë, kalohet nga botime të pjesshme fjalësh të shpjeguara në fund të çdo teksti të librave shkollorë të leximit, në një botim të plotë fjalori me kritere të përcaktuara, sigurisht sipas gjendjes së gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare të asaj kohe.

Ky fjalor, duhet thënë, u shkrua në dialektin geg. Trajta tepër dialektore pengoi përhapjen e tij në gjithë Shqipërinë dhe nuk e ndihmoi atë në jetëgjatësi. Por kjo nuk përbën një gabim, veçse wshtw njw pasqyrë e gjendjes së shqipes së atëhershme.

Gjithashtu, kritika e kohës, megjithëse e dobët, u shpreh që: “teper të randa janë shpjegimet e këtij fjalorthi për moshën e njomë e tepër të panjohura fjalët e tija për një libër leximi të asaj moshe” [2].

Pa dashur të bëjmë një shqyrtim të hollësishëm të këtij botimi të parë fjalorësh për fëmijë, dëshirojmë të nxjerrim në pah thelbin e kritikës së kohës, e cila është gjithashtu tregues i numërimit në vend të kësaj dege të leksikografisë shqiptare:

Fjalorthi nuk u mirëprit si një dukuri e re në leksikografinë shqiptare, nuk u pa si tharmi në bark të nënës, por ai vetëm u qortua për gabime në të gjitha këndvështrimet. P.sh., u pa si një e metë serioze fakti që “700 fjalë të fjalorthit të Logorecit gjinden edhe në fjalorët e Kristoforidhit, Meyerit e Bashkimit dhe në një numër fjalësh të tjera nuk janë vënë të gjitha kuptimet që janë në këta fjalorë për të rritur”. Pra, kritika e kohës nuk arriti të bënte dallimin tipologjik të këtij fjalori nga fjalorët

për të rriturit, nuk arriti të kuptonte karakterin e tij më shumë didaktik sesa njohës të botës, karakterin jofunksional të të dhënave historiko-etimologjike në këtë tip fjalori etj.

Të gjitha këto bënë që ky fjalorth të dëshkonte në misionin e tij dhe mësuesit e studiuesit pedagogjikë të vazhdonin, ashtu si më parë, me botimet e pjesshme të fjalëve të vështira në fund të çdo teksti të librave shkollorë. Kjo gjendje vazhdoi edhe gjatë periudhës së monizmit, edhe pas saj, ku leksikografët nuk e panë kurrë të mundshme të bënin objekt të punës së tyre, në bashkëpunim me studiuesit pedagogjik, një tip të tillë fjalori. Kjo vonesë historike e fjalorit për fëmijë, sigurisht, ka shpjegimet e veta:

Së pari, gjuha shqipe vazhdoi të shkruhej në dy dialektet kryesore deri më 1972, gjë që u bë pengesë për leksikografinë për fëmijë, e cila duhet të hartojë fjalorë me karakter didaktik për fëmijët e gjithë Shqipërisë. Për misionin që ka, ajo nuk mund ta pranojë ndarjen dialektore.

Së dyti, gjer në vitet 1964-1965 botimi i librave për fëmijë ka qenë i kufizuar.

Së treti, *Fjalori i fëmijëve* është një botim praktik, që bëhet mbi bazën e studimeve teorike jo vetëm në fushën e leksikologjisë, por edhe në atë të letërsisë. Studime të tilla sistematike për fëmijë kanë munguar për një kohë të gjatë. Më 1974, kur u mbajt Simpoziumi i Parë Kombëtar për problemet e letërsisë për fëmijë, fusha e studimit të letërsisë për fëmijë ishte ende në fillimet e saj [3]. Kështu që edhe në këtë simpozium, megjithëse u trajtua rëndësia dhe veçantia e gjuhës në letërsinë për fëmijë, nuk u shfaq ndonjë mendim për nevojën dhe rëndësinë e hartimit të një fjalori për fëmijë.

Së katërti, edhe sot nuk kemi studime të tilla të përbashkëta, gjë që ka shpënë në nisma vetjake, të cilat, megjithëse nuk janë kurorëzuar ende me botime konkrete, shënojnë një hap përpara në përpjekjet për zhvillimin e kësaj dege të leksikografisë shqiptare.

Një nismë e tillë është marrë qysh para pesë vjetësh nga punonjësit e departamentit të leksikologjisë e leksikografisë të IGJL-së të AShSh, N. Sotiri e H. Shehu, të cilët kanë thuar në përfundim hartimin e një fjalori për fëmijët e moshës 5-14 vjeç Për këtë fjalor, krahas përvojës leksikografike,

është shfrytëzuar edhe përvoja mësimore me fëmijë të moshës parashkollore e shkollore të ciklit të ulët, si dhe përvoja botërore. Synimi i tij është që t'u vijë në ndihmë kryesisht leximit jashtëshkollor dhe leximit të shoqëruar. Ky i fundit nënkupton leximin nga ana e prindërve për fëmijët që nuk dinë të lexojnë.

Sot, librat për fëmijë janë të shumtë. Kjo ka krijuar mundësinë që lënda për këtë fjalor të nxirret nga përrallat e tregimet që prindërit u lexojnë fëmijëve si dhe nga leximet e pavarura të vetë fëmijëve, me qëllim për të zgjuar përfytyrimin e tyre dhe për t'u zbuluar kënaqësitë që jep fjala. Janë përfshirë gjithashtu fjalë të jetës së përditshme, kryesisht ato që emërtojnë sende, cilësi dhe veprime. Kuptimi i një fjale të panjohur ose kuptimi i panjohur i një fjale të njohur jepet në një përmbajtje e mjedis që fëmija i njeh e i di shumë mirë. Është kjo arsyeja që fjala jo vetëm është dhënë në kontekst, por edhe konteksti është zgjedhur me kujdes, sipas kriteresh të përcaktuara paraprakisht mbi bazën e një metodike pedagogjike të studiuar në shërbim të kuptimit me lehtësi dhe saktësi të fjalëve. Pra, është hequr dorë nga shpjegimi i një fjale me fjalë të tjera, nga përkufizimi, sepse ky është shumë i vështirë për fëmijët, për shkak të karakterit të tij abstrakt. Janë bërë përpjekje për ta shndëruar thëllësisht atë në një parashtrim të plotë analitik, në një shembull të komentuar. Është mbajtur parasysh kështu përvoja e Marcel Cohen-it, i cili, duke mbrojtur përparësinë e kontekstit në fjalorët për fëmijë, thotë: "Meqenëse një fjalë ndërron kuptim sipas përdorimit që i bëhet, ne e përkufizojmë atë përgjithësisht vetëm pasi e kemi dhënë në një fjali shembull" [4]. Pra, fëmija e merr kuptimin e fjalëve fillimisht nëpërmjet kontekstit, nëpërmjet shembujve nga letërsia, të cilët jo vetëm lehtësojnë kuptimin e tyre, por edhe kalojnë fjalën e shkrimtarit te fëmijët.

Në shërbim të kësaj ideje, shpesh në këtë fjalor është përdorur edhe dialogu, sepse dialogu e vendos fjalën në një mjedis të gjallë jete. Përdoret një paraqitje e caktuar grafike për të dalluar menjëherë dialogun. Dialogu në fjalor është veçori vetëm e fjalorit për fëmijë dhe nuk është e lehtë t'ia gjesh vendin ashtu siç duhet. Ai është një risi

leksikografike botërore e këtyre viteve të fundit.

Gjithë sa thamë nuk nënkupton që në këtë tip fjalori nuk ka fare përkufizime dhe shpjegime fjalësh. Ato janë, madje sa herë që është e nevojshme, vetëm se ndryshe nga fjalorët për të rritur, në këtë tip fjalori, përkufizimet dhe shpjegimet vijnë pas shembullit, janë të thjeshta, analitike dhe të ndryshme për mosha të ndryshme. Kjo ka qenë një vështirësi e madhe për ne që zgjodhëm të bënim një fjalor për moshat nga 5 në 14 vjeç, sepse na ka detyruar që, brenda tij, të përzgjedhim me kujdes fjalët e moshës së vogël dhe t'i shoqërojmë ato me shembuj e shpjegime fare të thjeshta.

Në këtë fjalor jepen edhe gjëgjëza e pyetje për çështje të ndryshme, me anën e të cilave fëmija e kap më mirë kuptimin e përdorimit e fjalëve, ngulit më mirë në mendje atë çka është themelore në përrallat e tregimet që ka lexuar, nxitet të lexojë më shumë dhe, ajo që është më e rëndësishme, mësohet të qarkullojë nëpër fjalor, gjë që shpesh nuk dinë ta bëjnë edhe shumë të rritur.

Është mirë që ky lloj fjalori të shoqërohet me figura me ngjyra, sepse ato i bëjnë thirrje vëmendjes së fëmijës për ta pasuruar fjalorin e tij, duke u nisur nga personazhet dhe skenat që ai tashmë i njeh. Pra, figurat u bashkëngjiten konteksteve e dialogjeve, duke lehtësuar punën kërkuese të fëmijëve në fushë të leksikut, duke e bërë atë më tërheqëse dhe duke nxitur dëshirën e tyre për ta pasur patjetër në bibliotekë këtë libër.

Në këtë Fjalor ka edhe tabela, që u mundësojnë fëmijëve të marrin natyrshëm e pa vështirësi njohuritë e para për fjalorët tematikë.

Së fundi, për çdo fjalë e çdo kuptim fjale jepet përgjegjësjë në anglisht. Zgjidhja teknike për përfshirjen e gjuhës së huaj në këtë fjalor shpjegues shqip-shqip është e thjeshtë. Pra, kemi një gërshetim të fjalorit shpjegues me fjalorin dygjuhësh, gjë që lehtëson punën e fëmijës në përcaktimin pa mëdyshje të kuptimit të fjalës së huaj. Kjo rrit jo vetëm vlerën shkencore të *Fjalorit*, por edhe fushën e përdorimit të tij.

Pra, 100 vjet nga Kongresi i Manastirit nuk janë pak, por nuk janë edhe shumë, kur ka shumë probleme për të zgjidhur. Megjithatë, janë mjaftueshëm, kur nuk mungon dëshira dhe vullneti

për të shpënë përpara atë që me mundim ka nisur, por që është pjesë e së ardhmes.

Ne besojmë që me këtë fjalor do të ndihmojmë për ta nxjerrë nga ngërçi leksikografinë për fëmijë. Ne shpresojmë, gjithashtu, që hallkat shtetërore përkatëse do të dinë të japin ndihmesë konkrete, në mënyrë që kjo gjini e re dhe e domosdoshme e leksikografisë të vihet në shërbim të diturimit dhe jo të biznesit.

#### **BIBLIOGRAFIA**

1. *International Journal of Lexicography*, volume 15, nr. 1, March 2002, f. 75.
2. Revista *Leka*, Shkodër, 1936, nr. 12, f. 383.
3. Simpoziumi i Parë Kombëtar për problemet e letërsisë për fëmijë, Tiranë, 1974, f. 172
4. *International Journal of Lexicography*, volume 15, nr. 1, March 2002, f. 78.